

KREU 3

ZOTI SI KRIJUES

Asokohe, erdhi tek shën Andoni në shkretëtirë një dijetar i asaj kohe dhe i tha: "Si mundesh, uratë, dhe duron të jetosh këtu, i privuar nga gjithë ngushëllimi i librave?" Andoni iu përgjigj: "Libri im, filozof, është natyra e krijesave, dhe kurdo që të dëshiroj, mund të lexoj përmes saj veprat e Zotit."

Evagri i Pondit

Kuptoje se ke brenda, në një shkallë të vogël, një gjithësi të dytë: brenda teje është një diell, është një hënë dhe ka yje.

Origjeni

Ngre sytë në qiell

Aktorja Lillah McCarthy përshkruan se dikur, kur e braktisi i shoqi, mbytur e tëra në mjerim, shkoi për të takuar George Bernard Shaw-n:

Dridhesha. Shaw rrinte shumë qetë. Zjarri më sillte ngrohtësi ... Nuk e di sa ndenjëm kështu, por për pak u gjenda duke ecur me hapa zvarritës krahu Shaw-t ... lart e poshtë në Adelphi Terrace. Barra që më mundonte u lehtësua dhe i la lotët të rrëshqasin, që kurrë nuk do të vinin më parë ... Më la të qaj. Pastaj dëgjova një zë me të cilin fliste gjithë butësia dhe delikatesa e botës. Thoshte: "Shiko, e dashur, shiko lart në qiell. Në jetë ka më shumë se kjo, ka shumë më tepër."

Cilido që të ishte besimi i tij tek Zoti, ose madje nëse nuk besonte fare, Shaw këtu jep një dëshmi për diçka që është themelore për Udhën shpirtërore. Nuk e ngushëlloi Lillah McCarthy-n me fjalë të ëmbëla, as nuk u shtir duke i thënë se dhembja e saj do të ishte e lehtë për ta kaluar. Ajo që bëri ishte më largpamëse. I tha të shikojë për një çast jashtë vetes, jashtë tragjedisë personale dhe të kundrojë botën në objektivitetin e saj, të ndjejë mrekullinë dhe shumëllojshmërinë e saj, "gjendjen" e saj. Dhe këshilla e tij vihet në jetë nga të gjithë ne. Sa më tepër të mundohem nga brenga ime apo e të tjerëve, nuk duhet të harroj se në botë ka shumë më tepër brengë, shumë më tepër.

Shën Joani i Kronstandit thotë: "Lutja është një gjendje e një mirënjohjeje të vazhdueshme". Nëse nuk ndjej një ndjenjë gëzimi brenda krijesës së Zotit, nëse

harroj të kthej botën si dhuratë tek Zoti me mirënjohje, kam ecur shumë pak në Udhë. Ende nuk kam mësuar të jem me të vërtetë njerëzor. Sepse vetëm me anë të mirënjohjes mund të bëhem vetja ime. Mirënjohja gëzimplotë pa qënë sentimentale a e shkëputur nga realiteti, është përkundrazi plotësisht realiste - por me realizmin e atij që e shikon botën përmes Zotit, si krijesë hyjnore.

Ura me diamante

"Ti nga e mosqëna në të qënur na solle" (Mesha e shën Joan Gojartit). Si mund të kuptojmë lidhjen që ka Zoti me botën që ka krijuar? Çfarë nënkuptohet me shprehjen "nga e mosqëna", *ex nihilo*? Vërtet, përse krijoi Zoti?

Fjalët "nga e mosqëna" nënkuptojnë se Zoti e krijoi gjithësinë *me një akt të vullnetit të tij të lirë*. Asgjë nuk e shtrëngoi për të krijuar; e zgjodhi për ta bërë. Bota nuk u krijua pa ndonjë qëllim apo nga nevoja; nuk është një zanafillë e vetvetishme apo vërshim nga Zoti, por pasojë e alternativës hyjnore.

Në goftë se asgjë nuk e detyroi Zotin për të krijuar, atëherë përse vendosi t'a bëjë? Nëse mund t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje përgjigjja do të ishte kjo: motivi i Zotit për krijesën është dashuria e tij. Në vend që të themi se krijoi gjithësinë nga hiçi, duhet të themi se e krijoi nga vetë vetja e tij, që është dashuria. Nuk duhet t'a mendojmë Zotin si Prodhues a si Zejtari, por si të Dashur. Krijimi nuk është kaq një akt i vullnetit të tij të lirë, sesa i dashurisë së tij të lirë. Të duash do të thotë të pjesëtohesh, ashtu siç na ka treguar aq qartë dogma trinitare: Zoti nuk është vetëm një, por një brenda në tre, sepse është një shoqëri personash, që marrin pjesë njëri tek tjetri me dashuri.

Qarku i dashurisë hyjnore megjithatë nuk ka mbetur i mbyllur. Dashuria e Zotit është, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, "në ekstazë"- një dashuri që e bën Zotin të dalë nga vetja e tij dhe të krijojë gjëra të ndryshme nga vetë ai. Zoti e krijon botën nga dëshira e mrekullueshme me dashuri "në ekstazë", kështu që të ekzistojnë jashtë tij qenie të tjera për të marrë pjesë në jetë dhe në dashuri, të cilat janë të saj. Zoti nuk krijoi i detyruar; kjo nuk do të thotë se kishte diçka të rastësishme a të paqëndrueshme në këtë akt të krijimit. Zoti *është* gjitha ajo çka bën, dhe kështu akti i krijimit nuk është diçka e veçuar nga vetja e tij. Në zemrën e Zotit dhe në dashurinë e tij secili nga ne ka ekzistuar kurdoherë. Secilin nga ne Zoti e pa parajetësisht me mendjen hyjnore si një ide a mendim, dhe për secilin ka parajetësisht një plan të posaçëm dhe të veçantë. Gjithmonë ekzistonim për atë; krijim do të thotë se në një moment të caktuar kohe fillojmë të ekzistojmë dhe për veten tonë.

Si pemë e vullnetit të lirë dhe e dashurisë së lirë së Zotit, bota nuk është e domosdoshme, nuk është e vetëmjaftueshme, por është *relative* dhe *e varur*. Si krijesa kurrë nuk mund të jemi vetëm vetja jonë e vetme; Zoti është bërthama e qënies sonë, përndryshe pushojmë së qënuri. Në çdo rast jemi të varur në vetë ekzistencën tonë nga vullneti i dashur i Zotit. Të qënurit është një *dhuratë* nga Zoti - një dhuratë që nuk kthehet kurrë pas, por megjithatë është dhuratë, jo diçka që e zotërojmë me fuqinë tonë. Zoti vetë e ka arsyen dhe pikënisjen e të qënurit të tij brenda vetes së tij; të gjitha krijesat e kanë shkakun dhe burimin jo në vetvete por tek ai. Zoti i vetëm është vetë-burim; të gjitha krijesat burojnë nga Zoti, i kanë rrënjët e tyre tek Zoti dhe prejardhjen dhe plotësimin e tyre e gjejnë tek ajo. Zoti në vetvete është emri; të gjitha krijesat janë mbiemra.

Kur themi se Zoti është krijuesi i botës nuk nënkuptojmë thjesht se i vë sendet në lëvizje më një veprim fillestar "në fillim" mbas të cilit ato funksionojnë vetë. Zoti nuk është një orëbërës i universit, që kurdis aparatin dhe pastaj e lë të punojë vetë. Përkundrazi krijimi është *i vazhdueshëm*. Nëse duhet të jemi të përpiktë, kur flasim për krijimin, nuk duhet të përdorim të kryerën e thjeshtë, por të tashmen e vazhdueshme. Nuk duhet të themi se Zoti ndërtoi botën dhe mua brenda saj, por se "Zoti *ndërton* botën, dhe mua brenda në të, këtu dhe tani, këtë çast dhe gjithmonë". Krijimi nuk është një ngjarje e së shkuarës, por një marrëdhënie në të tashmen. Nëse Zoti nuk do të vazhdonte të ushtrojë vullnetin e tij krijues në çdo çast, gjithësia do të binte menjëherë në mosqenie. Asgjë nuk do të mund të ekzistonte as për një sekondë, nëse Zoti nuk do të donte të ekzistonte. Ashtu siç e thekson mitropoliti Filaret i Moskës: "të gjitha krijesat baraspeshohen mbi fjalën krijuese të Zotit, si në një urë më diamante; lart është humnera e paanësisë hyjnore, poshtë humbëtira e asgjësisë së tyre".

Kjo është e vërtetë madje dhe për Djallin dhe ëngjëjt e rrëzuar në ferr; sepse edhe ata e kanë të varur ekzistencën e tyre në vullnetin e Zotit.

Së këtejmi mund të themi se qëllimi i doktrinës mbi krijimin nuk është për të vendosur kronologjikisht një pikënisje për botën, por për të pohuar se në këtë moment këtu, ashtu si në gjithë momentet, bota var qenien e saj tek Zoti. Kur Gjeneza bën të ditur se "Në fillim Zoti krijoi qiellin dhe tokën" (Gjeneza 1:1), fjala "fillim" nuk duhet të merret thjesht në kuptimin kohor, por si domethënie e asaj se Zoti është arsyeja e përhershme dhe mbajtësja e të gjitha sendeve.

Pra si krijues Zoti ndodhet gjithmonë në zemrën e çdo sendi, duke e ruajtur atë në jetesë. Në planin e hulumtimit shkencor shquajmë disa procese a pasoja të arsyes dhe të rezultatit. Në planin e vizionit shpirtëror, i cili nuk e hedh poshtë

shkencën por sheh përtej saj, shquajmë kudo energjitë krijuese të Zotit, që përkujdesen për të gjitha sa ekzistojnë, që formojnë thelbin më të brendshëm të të gjitha sendeve. Por, ndërsa është i pranishëm kudo në botë, Zoti nuk duhet të njëjtësohet me botën. Si të krishterë pohojmë jo panteizmin por "panenteizmin". Zoti është *brenda* të gjitha sendeve, por gjithashtu *tej dhe mbi* të gjitha sendet. Është "më i madh nga më i madhi" dhe "më i vogël nga i vogli". Shën Grigor Pallamai thotë: "është kudo dhe kurrkund, është çdo gjë dhe kurrgjë". Siç e vendosi një murg kistersian i New Clairvaux-it: "Zoti është në bërthamë. Zoti është ndryshe nga bërthama. Zoti është brenda bërthamës dhe e përshton të tërë, dhe është përtej bërthamës, më afër bërthamës nga vetë bërthama."

"Dhe i pa Perëndia të gjitha sa krijoi dhe ja ishin shumë të mira" (Gjeneza 1:31). Krijimi në tërësinë e tij është art i duarve të Zotit; në thelbin e tyre më të brendshëm të gjitha krijesat janë "shumë të mira". Ortodoksia e krishterë hedh poshtë dualizmin e të gjitha formave: dualizmin radikal të manikenjve, që ia atribuojnë ekzistencën e së keqes një fuqie të dytë, të bashkëpërvjetshme me Zotin e dashurisë; dualizmin më pak radikal të gnostikëve valentinianë, që e shohin renditjen lëndore, përfshirë dhe trupin njerëzor, të krijuar si pasojë e një rënieje parabolore dhe dualizmin më të sendërgjuar të platonistëve, që e konsiderojnë materien jo si të keqe, por si joreale.

Kundër çdo forme të dualizmit, krishtërimi pohon se ekziston një *summum bonum*, një "e mirë supreme" - domethënë vetë Zoti - por nuk ekziston dhe nuk mund të ketë *summum malum* (e keqja supreme). E keqja nuk është e bashkëpërvjetshme me Zotin. Në fillim ishte vetë Zoti: të gjitha sendet që ekzistojnë janë krijesë e tij, qoftë në qiell, qoftë në tokë, qoftë shpirtërore, qoftë lëndore, dhe kështu në "gjendjen" e tyre themelore të gjitha janë të mira.

Atëherë çfarë duhet të themi për të keqen? Përderisa të gjitha krijesat janë të mira nga natyra e tyre, mëkati apo e keqja nuk është send, nuk është ekzistencë e qënësishme apo substancë. "Nuk pashë mëkat,- thotë Juliana e Norwich-ut në *Zbulimet* e saj, - sepse besoj se nuk ka asnjë lloj lëndë, nuk ka pjesë në të qënur; as mund të njihet përveçse nga dhimbja që shkakton." "Mëkati është asgjë", thotë shën Augustini. "Ajo që është e keqe, në kuptimin e rreptë,- vëren Evagri,- nuk është një lëndë, por mungesa e së mirës, ashtu si errësira nuk është asgjë tjetër veçse mungesa e dritës". "Dhe shën Grigori i Nisës shkruan: "Mëkati nuk është në natyrë pa vullnetin e lirë; nuk është një substancë e vërtetë". "As demonët nuk janë nga natyra e tyre të këqinj,- thotë Shën Maksim Konfessori,- por bëhen të këqinj nga përdorimi i fuqive të tyre natyrore". E keqja është gjithmonë parazitare. Është shtrembërimi dhe shpërdorimi i asaj që

është në vetvete e mirë. E keqja nuk banon tek vetë sendi, por tek sjellja jonë ndaj sendit - domethënë në vullnetin tonë.

Ndoshta duket se, duke përkufizuar të keqen si "asgjë", nënvlerësojmë fuqinë dhe dinamizmin e saj. Por, siç kishte vërejtur C. S. Lewis, hiçi është shumë i fuqishëm. Duke thënë se e keqja është një shtrembërim i së mirës dhe si rrjedhojë, në analizë të fundit, një iluzion dhe jorealitet, nuk duhet të mohojmë ndikimin e fortë të saj mbi ne. Sepse brenda krijimit nuk ka fuqi më të madhe se vullneti i lirë i qënieve që janë të pajisura me vetëdije dhe intelekt shpirtëror dhe kështu përdorimi i keq i këtij vullneti të lirë mund të ketë pasoja tërësisht të tmerrshme.

Njeriu si trup, shpirt dhe frymë

Por cili është vendi i njeriut brenda krijesës?

"Dhe vetë Perëndia i paqes u shenjtëroftë juve tërësisht dhe tërë qenien juaj: frymën, shpirtin dhe trupin, lutem që t'i ruani të panjolllosura gjer në ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht" (1 Thesalonikasit 5:23). Këtu shën Pavli përmend tre elementët ose aspektet që përbëjnë personin njerëzor. Megjithëse të ndryshëm, këta aspekte janë të ndërvarura ngushtë; njeriu është një unitet i shkrirë në një të tërë, jo në një tërësi që përmbledh pjesë të ndara.

Së pari është *trupi*, "dhë nga toka" (Gjeneza 2:7), aspekti fizik ose lëndor i natyrës njerëzore.

E dyta është *fryma*, fuqia që gjallëron dhe frymëzon trupin, duke e bërë atë që të mos jetë vetëm një objekt lëndor, por diçka që zmadhohet dhe lëviz, që ndjen dhe percepton. Edhe kafshët kanë frymë, ndoshta edhe bimët. Por në rastin e njeriut fryma është e përzier me vetëdije; është një frymë e arsyeshme që ka aftësinë e të menduarit abstrakt, dhe zotësinë për të përparuar me argumente të panumërt arsyesimesh në një konkluzion. Këto forca ekzistojnë tek kafshët - në mos fare vetëm në një shkallë shumë të kufizuar.

E treta është *shpirti*, "frymëmarrja" nga Zoti (shih: Gjeneza 2:7), që kafshët nuk e kanë. Është e rëndësishme të veçojmë "Shpirtin" me shkronjë të madhe dhe "shpirtin" me shkronjë të vogël. Shpirti i krijuar i njeriut nuk duhet të njëjtësohet me të pakrijuarin ose Shpirtin e Shenjtë të Zotit, personit të tretë të Trinisë së Shenjtë; megjithëse që të dy janë të lidhur ngushtë, sepse me shpirtin e tij njeriu percepton Zotin dhe komunikon me të.

Me frymën (*psyche/psihë*) njeriu angazhohet në hulumtimet shkencore a filozofike, duke analizuar të dhënat e përvojës së tij shqisore brenda arsyes së pafund. Me shpirtin (*pneuma/pnevma*) e tij, që disa herë quhet *nous/nus* ose mendje (intelekt shpirtëror), ai kupton të vërtetën e përjetshme për Zotin, apo për *logoi* (shumësi i fjalës *logos*), a esencat e brendshme të krijesave, jo me arsyetime deduktive, por me kuptimin e saj të drejtpërdrejtë ose perceptim shpirtëror, me një lloj intuete që shën Isak Siriani e quan "njohje të thjeshtë". Për rrjedhojë shpirti ose mendja ndryshe nga aftësitë arsyetuese të njeriut dhe emocionet që përftojnë përmes shqisave, është gjithnjë më superior nga të dyja.

Meqënëse njeriu ka një shpirt arsyetues dhe një mendje shpirtërore, zotëron forcën e vetëvendosjes dhe të lirisë morale, d.m.th. ndjenjën e së mirës dhe së keqes dhe aftësinë për të zgjedhur midis tyre. Atje ku kafshët veprojnë me anë të instiktit, njeriu mund të marrë një vendim të lirë dhe të vetëdijshëm.

Disa herë etërit e kishës pranojnë një skemë jo tripalëshe por dypalëshe, duke e përshkruar njeriun si një bashkim trupi dhe shpirti; në këtë rast e konsiderojnë shpirtin ose intelektin si aspektin më të lartë të frymës. Por skema e trefishtë e trupit, shpirtit dhe frymës është më e saktë dhe më ndriçuese, veçanërisht në kohën tonë kur shpirti dhe fryma shpesh ngatërrohen, dhe kur shumica e njerëzve nuk janë në dijeni se kanë a s'kanë intelekt shpirtëror. Kultura dhe sistemi arsimor i Perëndimit bashkëkohor bazohet pothuajse vetëm në të ushtruarit e trurit arsyetues dhe, në një shkallë më të vogël, në emocionet shqisore. Shumica prej nesh, kemi harruar se nuk jemi vetëm tru dhe vullnet, shqisa dhe ndijime, por se jemi gjithashtu edhe frymë. Njeriu i sotëm, në pjesën më të madhe, e ka humbur lidhjen me aspektin më të vërtetë dhe më të lartë të vetes së tij dhe rezultatin e kësaj tëhuajtjeje të brendshme mund t'a shohim shumë thjesht në shqetësimin e tij, në mungesën e identitetit dhe në humbjen e shpresës.

Mikrokozmos dhe ndërmjetës

Trup, shpirt dhe frymë, - tre brenda në një, njeriu zotëron një vend të vetëm në krijim.

Sipas botëkuptimit ortodoks, Zoti ka krijuar dy nivele krijesash: së pari nivelin "mendtor", "shpirtëror" ose "intelektual", dhe së dyti atë lëndor ose trupor. Në nivelin e parë Zoti krijoi ëngjëjt që nuk kanë trup lëndor. Në nivelin e dytë Zoti krijoi gjithësinë natyrore - galaktikat, yjet, planetet, me llojet e ndryshme të

jetesës në minerale, bimë dhe kafshë. Njeriu dhe vetëm njeriu ekziston njëkohësisht edhe në të dy nivelet. Me frymën apo intelektin shpirtëror merr pjesë në mbretërinë mendore dhe është bashkudhëtar i ëngjëjve; me trupin dhe shpirtin e tij lëviz, ndjen dhe mendon, ha dhe pi, duke e shndërruar ushqimin në energji dhe duke marrë pjesë organikisht në mbretërinë lëndore, të cilën e përshkon me anë të shqisave të tij.

Pra natyra jonë njerëzore është më e ndërlikuar sesa ajo ëngjëllore, dhe e pajisur me mundësi më të gjera. I parë në këtë perspektivë, njeriu nuk është më poshtë por më lart nga ëngjëjt; ashtu siç pohon Talmudi babilonian: "Të drejtët janë më të mëdhenj nga ëngjëjt që i shërbejnë Perëndisë" (*Sanhedrin* 93a). Njeriu ndodhet në zemër të krijimit të Zotit. Duke marrë pjesë dhe në mbretërinë mendore dhe në atë lëndore, është një shëmbëlltyrë apo pasqyrë e gjithë krijimit, *imago mundi*, një "gjithësi e vogël" ose mikrokozmos. Të gjitha krijesat takohen tek ai. Njeriu mund të shprehet për veten e tij me fjalët e Kathleen Raine:

Nga që dashuroj
dielli hedh rrezet e arta plot gjallëri,
hedh arin dhe argjendin e tij mbi det...
Nga që dua
fieri gjallëron dhe gjelbëron dhe bari,
dhe blerojnë pemët e tejdukshme plot diell...
Sepse dua
gjithë natën lumi rrjedh në gjumin tim,
mijëra krijesa të gjalla flenë në prehrin tim,
dhe teksa flenë dhe, ndërsa rrjedhin prehen...

Duke qënë një mikrokozmos njeriu është gjithashtu ndërmjetës. Është vepër e krijuar nga Zoti që të bashkërendojë mbretërinë mendore dhe atë lëndore, të bashkojë, të shpirtëzojë lëndën, dhe të nxjerrë në dukje të gjitha aftësitë e fshehura të krijimit. Ashtu siç e ka shprehur Hasidimi hebraik: "Njeriu ftohet të përparojë shkallë-shkallë gjer atje ku, nëpërmjet tij, të bashkohet çdo gjë". Pra, si mikrobotë, njeriu është i vetmi brenda të cilit përmblihet bota; si ndërmjetës është i vetmi përmes të cilit bota i kthehet Zotit si dhuratë.

Njeriu mund të ushtrojë këtë rol ndërmjetës vetëm sepse natyra e tij njerëzore është thelbësisht dhe thellësisht një unitet. Nëse ishte vetëm një shpirt që banon përkohësisht në një trup, ashtu si shumë filozofë grekë dhe indianë e kanë përfytyruar - nëse trupi i tij nuk ishte pjesë e vetes së tij të vërtetë, por

vetëm një copë pëlhurë që së fundi do t'a lërë mënjanë, apo një burg nga ku përpiqet të arratiset - atëherë njeriu nuk do të mundte të veprojë drejt si ndërmjetës. Njeriu shpirtëzon krijimin, para së gjithash duke shpirtëruar vetë trupin e tij dhe duke ia dhuruar Zotit: "Apo nuk e dini se trupi juaj është tempull i Shpirtit të Shenjtë që banon tek ju? - shkruan Shën Pavli. ... Lavdëroni Perëndinë me trupin tuaj... Ju lutem pra, o vëllezër, për hir të përdëllimeve të Perëndisë, të blatoni veten tuaj si therorë të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer tek Perëndia" (1 Korinthianët 6:19 - 20; Romakët 12:1). Por duke "shpirtëzuar" trupin, njeriu nuk e çlëndëzon: përkundrazi, është prirja njerëzore për të shfaqur shpirtëroren *brenda dhe përmes lëndores*. Në këtë kuptim të krishterët janë të vetmit materialistë të vërtetë.

Pra, trupi është një pjesë e pandarë e personalitetit njerëzor. Ndarja e trupit nga shpirti në vdekje është jonatyrore, diçka e kundërt me planin fillestar të Zotit, që ka ardhur si pasojë e rënies. Për më tepër, ndarja është vetëm e përkohshme; presim, tej vdekjes ngjalljen finale "në ditën e fundit", kur trupi dhe shpirti do të ribashkohen edhe një herë.

Imazh dhe ngjasim

"Lavdia e Zotit është njeriu", - pohon Talmudi (*Derech Eretz Zutta 10,5*); dhe shën Irineu konstaton njësoj: - "Lavdia e Zotit është një njeri i gjallë." Personi njerëzor formon qendrën dhe kulmin e krijimit të Zotit. Pozita e vetme e njeriut në botë duket mbi të gjitha nga fakti se është krijuar "sipas shëmbëllesës dhe ngjashmërisë" së Zotit (Gjeneza 1,26). Njeriu është një shprehje e vetëshprehjes së pafund të Zotit.

Disa herë etërit grekë e përqasin shëmbëllesën/imazhin hyjnor ose "ikonën" tek njeriu me tërësinë e natyrës së tij, që konsiderohet si bashkim i tre elementeve: i frymës, shpirtit dhe trupit. Herë e konsiderojnë imazhin më të drejtpërdrejtë në aspektin më të lartë të njeriut, me frymën ose me intelektin shpirtëror, me të cilin fiton njohje të Zotit dhe bashkohet me të. Kryesisht imazhi i Zotit tek njeriu, tregon çdo gjë që veçon njeriun nga kafshët, që e bën në kuptimin e plotë dhe të vërtetë një person - një faktor moral të aftë për të drejtën dhe për gabimin, një qenie shpirtërore të pajisur me liri të brendshme.

Aspekti *i zgjedhjes së lirë* është veçanërisht i rëndësishëm për të kuptuar njeriun e krijuar sipas imazhit të Zotit. Përderisa Zoti është i lirë, dhe njeriu është gjithashtu i lirë. Duke qenë e lirë, çdo qenie njerëzore ndërgjegjëson imazhin hyjnor brenda saj me mënyrën e vet dalluese. Qeniet njerëzore nuk janë të

kundërta saqë mund të shkëmbehen midis tyre, ose pjesë këmbimi të një makinerie. Secili duke qënë i lirë është i papërsëritshëm dhe, secili duke qënë i papërsëritshëm është pafundësisht i çmuar. Personat njerëzorë nuk mund t'i masim sipas sasisë; nuk kemi të drejtë të themi se një person në fjalë ka vlerë më të madhe nga cilido person tjetër, apo se dhjetë persona detyrimisht duhet të kenë vlerë më të madhe sesa një i tillë. Përlllogaritje të tilla janë një fyerje për personalitetin autentik. Secili është i pazëvendësueshëm dhe si rrjedhojë secili duhet të trajtohet si një *qëllim* i vetvetes, dhe kurrë si një mjet për ndonjë qëllim të mëtejshëm. Secili nuk duhet të shihet si objekt por si subjekt. Nëse i gjejmë njerëzit të bezdisshëm dhe mërzitshmërisht të njëjtë, kjo ndodh ngaqë s'kemi arritur në nivelin e personalitetit të vërtetë, për të tjerët dhe vetveten, ku nuk ekzistojnë stereotipë, por secili në vetvete është unik.

Shumë nga etërit grekë, në mos të gjithë, vënë re një ndryshim midis "imazhit" të Zotit dhe "ngjashmërisë" së Zotit. Imazhi, për ata që i ndajnë të dy termat, tregon *mundësinë* e njeriut për të jetuar brenda Zotit, ndërsa ngjashmëria është *sendërtimi* i kësaj mundësie. Imazhi është ajo që njeriu zotëron qysh në fillim dhe që i jep fuqinë për t'a nisur që nga fillimi Udhën shpirtërore; ngjashmëria është ajo që shpreson të fitojë në fund të udhëtimit. Me fjalët e Origjenit: "Njeriu mori nderin e imazhit në krijimin e tij të parë, por përsosja e plotë drejt përgjasimit të Zotit do t'i jepet në përfundimin e të gjithave". Të gjithë njerëzit janë të bërë sipas imazhit të Zotit dhe, sado e prishur që të jetë jeta e tyre, imazhi hyjnor brenda tyre është thjesht i mugëtuar dhe i mbuluar, por kurrë krejtësisht i humbur. Ngjasimi arrihet vetëm nga të zgjedhurit e mbretërisë qiellore të Jetës së ardhshme.

Sipas shën Irineut, njeriu në krijimin e tij të parë ishte "si një fëmijë e vogël" dhe kishte nevojë të "shtohet" drejt përsosjes së tij. Njeriu, me fjalë të tjera, në krijimin e tij të parë ishte i çiltër dhe i aftë për t'u zhvilluar shpirtërisht (imazhi), por ky zhvillim nuk ishte i pashmangshëm apo i vetvetishëm. Njeriu u thirr të bashkëpunojë me hirin e Zotit dhe kësaj, me përdorimin e drejtë të vullnetit të lirë të tij, ngadalë dhe gradualisht duhej të bëhej i përsosur, siç është Zoti (ngjashmëria). Kjo tregon që njohja se njeriu u krijua sipas imazhit të Zotit, mund të shpjegohet me një kuptim dinamik sesa statik. Kjo nuk do të thotë se njeriu ishte i pajisur që në fillim me një shenjtëri dhe njohuri plotësisht të vetëdijshme, por thjesht se i ishte dhënë *mundësia për t'u rritur* në kungim të plotë me Zotin. Dallimi imazh-ngjashmëri nuk nënkupton, natyrisht, pranimin e ndonjë "teorie të evolucionit", por as edhe është i papajtueshëm me një teori të tillë.

Imazhi dhe ngjashmëria do të thotë orientim, marrëdhënie. Siç vëren Philip Sherrard, "vetë koncepti i njeriut nënkupton një marrëdhënie, një lidhje me Zotin. Atje ku pohohet njeriu, pohohet dhe Zoti". Duke besuar se njeriu është krijuar sipas imazhit të Zotit, besojmë se njeriu është krijuar për komunikim dhe bashkim me Zotin dhe se, nëse e hedh poshtë këtë komunikim pushon së qenuri njeri me të gjitha cilësitë. Nuk ekziston i ashtuquajti "njeriu natyror", veç Zotit; njeriu që është i ndarë nga Zoti është në një gjendje shumë jónatyrore. Doktrina e imazhit do të thotë, si rrjedhojë, se njeriu e ka Zotin si qendrën më të brendshme të qenies së tij. Elementi hyjnor është vendimtar në të qenurit njeri; duke humbur ndjenjën e hyjnore, humbasim gjithashtu dhe domethënien e asaj që është njerëzore.

Kjo është vërtetuar çuditërisht nga çka ndodhën në Perëndim në epokën e Rilindjes, dhe më dallueshëm gjatë revolucionit industrial. Një sekularizim në rritje është shoqëruar nga një çnjerëzim i shoqërisë që vazhdimisht zgjerohet. Shembullin më të qartë për këtë mund ta shohim në formën leninisto-staliniste të komunizmit, ashtu siç ishte në Bashkimin Sovjetik: atje mohimi i Zotit ecte krahu një shtypjeje të egër të lirisë personale të njeriut. Kjo nuk është aspak e papritur. E vetmja bazë e sigurt për një doktrinë të çlirimit njerëzor dhe të dinjitetit njerëzor është bindja se çdo njeri është në imazhin e Zotit.

Njeriu është i bërë jo vetëm sipas imazhit të Zotit, por më konkretisht, sipas imazhit të *Zotit trinik*. Të gjitha sa u thanë më sipër për "përjetimin e Trinisë" fitojnë më tepër vlerë, kur shprehen me terma të doktrinës së imazhit. Përderisa imazhi i Zotit tek njeriu është trinik, nënkupton se njeriu, ashtu si Zoti, bëhet i vetëdijshëm për natyrën e tij të vërtetë me jetën e ndërsjelltë. Imazh do të thotë marrëdhënie jo vetëm me Zotin por edhe me njerëzit e tjerë. Ashtu si tre personat hyjnorë jetojnë brenda dhe njëri për tjetrin, kështu dhe njeriu - duke u krijuar sipas imazhit trinik - bëhet person i vërtetë duke e parë botën brenda syve të të tjerëve, duke i bërë të vetat gëzimet dhe hidhërimet e të tjerëve. Çdo qenie njerëzore është e vetme, por secili brenda të qenurit i vetëm është krijuar për të komunikuar me të tjerët.

"Ne që besojmë, duhet t'i shohim të gjithë besimtarët si një person të vetëm... dhe duhet të jemi të gatshëm të japim jetën për hir të fqinjit tonë" (Shën Simeoni, Teologu i Ri). "Nuk ka mënyrë tjetër për të shpëtuar përveçse nëpërmjet të afërmit tonë. Kjo është pastërtia e zemrës: kur sheh mëkatarin apo të sëmurin, duhet të ndjesh dhimbje dhe të tregosh dhembshuri" (*Ligjërimet e shën Makarit*). "Pleqtë e kanë zakon të thonë se duhet që secili të vërejë përvojat e të afërmit, sikur të ishin të vetat. Duhet të vuajmë me fqinjin/të afërmin tonë në çdo gjë dhe bashkë me të, dhe të sillemi sikur të ishim brenda trupit të tij;

dhe nëse e shohim të brengosur, duhet të ndjejmë të njëjtin pikëllim që do të ndjenim për veten tonë" (*Fjalë të urta nga etërit e shkretëtirës*) Të gjitha këto janë të vërteta, pikërisht sepse njeriu është i bërë sipas imazhit të Zotit trinik...

Prift dhe Mbret

I krijuar sipas imazhit hyjnor, si mikrokozmos dhe ndërmjetës, njeriu është prift dhe mbret brenda krijimit. Me vetëdije dhe paramendim të matur mund të bëjë dy gjëra që kafshët mundën vetëm pa vetëdije dhe instiktivisht. Së pari, njeriu mund të bekojë dhe të himnojë Zotin për botën. Njeriu përkufizohet më mirë jo si një kafshë "llogjike", por si një kafshë "eukaristike". Nuk jeton thjesht brenda në botë, mundohet për të dhe e përdor, por dhe mund t'a shohë botën si dhuratë të Zotit, si një mister të pranisë së Zotit dhe një mjet komunikimi me të. Kësisoj mund t'ia kthejë botën si dhuratë Zotit me falënderimin: "Të tuat nga të tuat Ty të blatojmë nga të gjitha dhe për të gjitha" (Mesha e shën Joan Gojartit).

Së dyti, përveç bekimit dhe himnimit të Zotit për botën, njeriu gjithashtu mund të riformojë dhe të zhvillojë botën dhe t'i japë kështu një domethënie të re. Me fjalët e at Dumitru Staniloae: "njeriu vë vulën e arsyetimit dhe të veprës së tij shpirtërore mbi krijimin... Bota nuk është vetëm një dhuratë, por dhe një vepër për njeriun". Është prirja jonë për të bashkëpunuar me Zotin; siç pohon dhe shën Pavli: "Sepse ne jemi bashkëpunëtorë me Perëndinë" (1 Korinthianët 3:9). Njeriu nuk është vetëm një kafshë llogjike dhe eukaristike, por është gjithashtu dhe gjallesë krijuese. Fakti se njeriu është sipas imazhit të Zotit do të thotë se njeriu është krijuar sipas imazhit të Zotit krijues. Këtë rol krijues e përmbush jo me fuqi shtazarake, por me kthjelltësinë e vizionit shpirtëror; prirja e tij nuk është për të sunduar dhe për të shfrytëzuar natyrën, por për t'a transformuar dhe për t'a shenjtëruar atë.

Me një larmi mënyrash - me kultivimin e tokës, me zejtarinë, me shkrimin e librave dhe paraqitjen e ikonave - njeriu u jep jetë sendeve lëndorë dhe bën natyrën të himnizojë Zotin. Është plot domethënie puna e parë e Adamit të parëkrijuar për të emërtuar së pari kafshët (Gjeneza 2:19-20). Emërdhënia është në vetvete një akt krijues; derisa të gjejmë një emër për ndonjë objekt a përvojë, një fjalë "të pashmangshme" që të tregojë karakterin e vërtetë të atij sendi, nuk mund të fillojmë t'a kuptojmë dhe t'a përdorim. Është gjithashtu domethënës fakti se, kur në Eukaristinë Hyjnore i kthejmë Zotit duke i blatur pemët e para të tokës, nuk i ofrojmë ato në trajtën fillestare, por të shndërruara nga dora e njeriut; nuk sjellim në altar togje me grurë por "blatë", nuk sjellim rrushë por verë.

Kështu pra njeriu është prift i krijimit me forcën që ka për të falënderuar dhe për të ridhuruar krijimin të Zotit dhe është mbret i krijimit me fuqinë që ka për të ndërtuar dhe për të dhënë formë, të lidhë dhe të diferencojë. Ky funksion priftëror dhe mbretëror përshkruhet bukur nga Shën Leondi i Qipros:

Me qiellin dhe tokën dhe detin, me drurin dhe gurin, me gjithë krijimin e dukshëm dhe të padukshëm, i blatoj adhurim krijuesit dhe Zotit dhe Bërësit të të gjithave. Sepse krijesa nuk adhuron dot drejtpërdrejt dhe vetëm Bërësin, por me gojën time qiejt rrëfejnë lavdinë e Zotit, hëna e adhuron, yjet e lavdërojnë, uji dhe pikat e shiut dhe gjithë krijesa, e adhurojnë Zotin dhe e lavdërojnë.

Ide të ngjashme shprehen nga mësuesi i hasidenjve, Abraham Yaakov i Sadagoras:

Të gjitha krijesat, dhe bimët dhe kafshët, sjellin dhe i ofrojnë njeriut vetveten, por nëpërmjet njeriut sillen të gjitha dhe i blatojnë Zotit. Kur njeriu pastrohet dhe shenjtërohet në të gjithë gjymtyrët e tij si një blatim ndaj Zotit, ai pastron dhe shenjtëron të gjitha krijesat.

Mbretëria e brendshme

"Lum ata që kanë zemër të pastër, sepse ata do të shohin Perëndinë" (Matheu 5:8). I krijuar sipas imazhit të Zotit, njeriu është pasqyra e hyjnore. E njeh Zotin duke njohur vetveten; duke depërtuar në vetvete, sheh Zotin të reflektohet në pastërtinë e zemrës së tij. Dokrina e krijimit të njeriut sipas imazhit do të thotë se brenda çdo njeriu - brenda në vetveten më të vërtetë dhe më të brendshme të tij, që shpesh përkufizohet si "thellësi e zemrës" ose "truall i shpirtit" - ka një pikë takimi dhe bashkimi direkt me të Pakrijuarin. "Mbretëria e Perëndisë është në mes jush" (Lluka 17:21).

Ky takim me mbretërinë e brendshme është një nga temat kryesore në shkrimet e etërve të Kishës. "Më i madhi nga të gjitha mësimet, - thotë shën Klementi i Aleksandrisë, - është njohja e vetvetes; sepse, nëse dikush njeh vetveten, do të njohë Zotin dhe nëse njeh Zotin, do të bëhet si Zoti". Shën Vasili i Madh shkruan: "Kur mendja pushon të merret me gjërat e jashtme ose ti nënshtrohet botës së shqisave, kthehet në vetvete; dhe përmes saj ngjitet në mendimin e Zotit". "Ai që njeh vetveten, i njeh të gjitha", thotë shën Isak Siriani; dhe diku gjetkë shkruan:

Paqësohu në shpirt, atëherë qielli dhe toka do të jenë në paqe me ty. Futu me padurim në thesarin që ndodhet brenda teje dhe kështu do të shikosh ato që ndodhen në qiell; sepse ka vetëm një hyrje që të shpie në të dyja ato. Shkalla që të shpie në Mbretëri është e fshehur brenda shpirtit tënd. Largohu nga mëkati, zhytu në vetvete dhe brenda në shpirt do të zbulosh shkallët nga ku do të ngjitesh.

Dhe këtyre copëzave do të mund t'iu shtonim dëshminë e një dëshmitari perëndimor të ditëve tona, të Thomas Merton:

Në qendrën e qënies sonë ka një pikë asgjëje që është e paprekur nga mëkati dhe mashtrimi, një pikë e së vërtetës së pastër, një pikë ose shkëndijë që i përket tërësisht Zotit, që nuk është kurrë në dispozicionin tonë, nga e cila Zoti rregullon jetët tona, që është e paafroshme në fantazitë e mendimeve tona apo të shtazërive të vullnetit tonë. Kjo pikë e vogël e asgjësë dhe e varfërisë së plotë është lavdia e pastër e Zotit brenda nesh. Është, si të thuash, i shkruar brenda nesh emri i tij, ashtu si varfëria jonë, ashtu si skamja jonë, ashtu si vartësia jonë, ashtu si birësia jonë. Është si një dinamit i pastër që vetëtin në dritën e padukshme të qiellit. Është brenda secilit dhe, nëse mundnim t'a shihnim, do të vërenim këto miliona rreze drite tek vijnë bashkë me trajtën dhe shkëlqimin e një dielli që do të bënte gjithë mugëtirën dhe mizorinë e jetës të zhduket krejtësisht... Porta e qiellit ndodhet kudo.

Largohu nga mëkati, këmbëngul shën Isaku; dhe këto tre fjalë duhet veçanërisht të theksohen. Nëse bëhet fjalë të shohim faqen e Zotit të reflektohet brenda nesh, pasqyra duhet të pastrohet. Pa pendim nuk mund të ketë vetënjohje dhe zbulim të mbretërisë së brendshme. Kur më thuhet, "kthehu në vetvete, njih veten tënde", është e nevojshme të pyes: Për cilën "vetvete" bëhet fjalë të zbuloj? Çfarë është vetja ime e vërtetë? Psikanaliza na vë në dukje një tip "vetveteje"; por, shumë shpesh ajo na udhëheq jo në "shkallën e mbretërisë", por në shkallën që zbret në një bodrum të lagësht dhe plot gjarpërinj. Njih veten tënde, do të thotë njih vetveten kështu siç buron nga Zoti, kështu siç ka rrënjët tek Zoti; njih veten tënde brenda Zotit.

Nga këndvështrimi i traditës shpirtërore ortodokse duhet të theksohet se nuk do t'a zbulojmë veten tonë të vërtetë "sipas shëmbëllesës", përveçse brenda një vdekjeje të rreme dhe të rrëzuar të vetes sonë; "Ai që do të humbasë jetën e tij për hir tim, do t'a gjejë atë (Matheu 16:25): vetëm ai që sheh veten e tij të rreme, ashtu siç është, dhe e hedh poshtë atë, ai do të mund të shquajë veten e vërtetë të tij, vetveten që sheh Zoti. Duke nënvizuar këtë dallim midis vetvetes së rreme dhe asaj të vërtetë, shën Varsanufi porositi: "Harroje veten dhe do t'a njohësh atë."

E keqja, dhimbja dhe rënia e njeriut

Në romanin madhor të Dostojevskit, *Vëllezërit Karamazov*, Ivani provokon vëllain e tij:

- Le të supozojmë se krijon ndërtesën e fatit njerëzor me synimin për të bërë njerëzit të lumtur tek e fundit, dhe t'u japësh paqe dhe prehje; por që t'a bësh këtë, lipset të torturosh vetëm një foshnjë të vogël... dhe të themelosh ngrehinën tënde mbi lotët e saj. Do të pranoje t'a merrje përsipër ndërtimin me këtë kusht?

"Jo, nuk do të pranoja",- përgjigjet Aljoshja. Dhe nëse ne nuk do të pajtoheshim me këtë, përse pra e bën, siç duket, Zoti?"

Somerset Maugham na thotë se qëkur kishte parë një fëmijë të vogël tek po vdiste dalëngadalë nga meningjiti, nuk mund të besonte më në Zot dashurie. Ndërsa të tjerë duhet të shihnin një bashkëshort a bashkëshorte, një fëmijë a një prind të bjerë në një depresion të plotë. Në gjithë mbretërinë e dhimbjes ndoshta nuk ka gjë më të tmerrshme sesa kur shohim një qenie njerëzore me melankoli kronike. Cila është përgjigja jonë? Si mund t'a pajtojmë besimin në një Zot dashurie, i cili krijoi të gjitha gjërat dhe tha se ishin "shumë të mira", me ekzistencën e dhimbjes, të mëkatit dhe të së keqes?

Duhet të pranojmë se nuk është e mundur një përgjigje e lehtë apo një pajtim gjykimesh. Dhimbja dhe e keqja na përballin shpërpjestimisht. Vuajtja jonë dhe e të tjerëve, është një përvojë që duhet të përjetojmë dhe jo një problem teorik që mund të zgjidhim. Në qoftë se ka një shpjegim, ai është në një nivel më të thellë se sa fjalët. Vuajtja nuk mund të "justifikohet"; por mund të përdoret, të pranohet dhe përmes këtij pranimi të shndërrohet. "Paradoksi i vuajtjes dhe i së keqes, - thotë Nicolas Berdyaev, zgjidhet me përvojën e përdëllimit dhe të dashurisë."

Por, ndërsa me të drejtë tregojmë mosbesim për çdo zgjidhje të lehtë të "problemit të së keqes", mund të gjejmë në rrëfimin për rënien e njeriut, që jepet në kreun e tretë të Gjenezës - pavarësisht se mund të interpretohet literalisht ose simbolikisht - dy pika jetësore, që duhet të lexohen me vëmendje.

Së pari, tregimi në Gjenezë fillon duke bërë fjalë për "gjarpërin" (Gjeneza 3:1), d.m.th. djallin - të parin e atyre ëngjëjve që u larguan nga Zoti drejt skëterrës së vullnetit të tyre. Ndodhi rënia e dyfishtë: në fillim e ëngjëjve dhe pastaj e njeriut. Për ortodoksinë rënia e ëngjëjve nuk është një trillim piktoresk, por e vërtetë shpirtërore. Para krijimit të njeriut, kishte ndodhur pra një ndarje në

udhët e mbretërisë mendore: disa prej ëngjëjve mbetën të vendosur duke iu bindur Zotit, ndërsa të tjerë e mohuan. Përsa i përket kësaj "luftë në qiell" (Zbulesa 12:7) kemi vetëm referime kriptike brenda shkrimit por nuk na thuhet me hollësi se çfarë ndodhi dhe, akoma më pak dimë për planet që ka Zoti për një pajtim të mundshëm brenda mbretërisë mendore, apo nëse djalli më në fund (a në mos fare) do të mund të shpëtojë. Ndoshta, siç duket tërthorazi në kreun e parë të librit të Jobit, Satani nuk është kaq i zi sa e pikturojnë zakonisht. Për ne, në këtë fazë të ekzistencës sonë tokësore, Satani është armiku; por Satani ka gjithashtu një lidhje të drejtpërdrejtë me Zotin, për të cilën nuk dimë asgjë dhe për të cilën nuk është e udhës të vrasim mendjen; le të shikojmë punën tonë.

Megjithatë, në përpjekjet tona për t'u marrë me problemin e dhembjes, duhet të shënohen tre pikat që na interesojnë: Së pari, përveç së keqes, për të cilën ne njerëzit jemi personalisht përgjegjës, në gjithësi ka fuqi me potencë vigane, vullneti i së cilave është drejtuar kah së keqes. Këto fuqi, pavarësisht se nuk janë njerëzore, janë prapëseprapë personale. Ekzistenca e këtyre fuqive demoniake nuk është një hipotezë a një legjendë, por - për shumë nga ne, mjerisht! - një çështje e një përvoje të drejtpërdrejtë. Së dyti, ekzistenca e fuqive të rrëzuara shpirtërore na ndihmon të kuptojmë se, në një moment kohor me sa duket para krijimit të njeriut, duhet të mbizotëronte në botën natyrore çrregullsi, prishje dhe egërsi. Së treti, rebelimi i ëngjëjve tregon shumë qartë se e keqja buron jo nga poshtë por nga lart, jo nga lënda por nga fryma. E keqja, ashtu siç theksohet me të drejtë, është "asgjë" dhe jo një qenie apo substancë ekzistente, por një qëndrim i gabuar kundrejt asaj që në vetvete është e mirë. Burimi i së keqes, si rrjedhojë, ndodhet në vullnetin e lirë të qënieve shpirtërore, që janë pajisur me zgjedhje morale dhe e përdorin këtë forcë gabimisht.

Këto në lidhje me pikën e parë, ku hidhet fjala për "gjarpërin". Por (dhe ndofta kjo na shërben si tregues i dytë) rrëfimi sqaron se, megjithë që njeriu vjen në jetë brenda një bote të prishur më parë nga rënia e ëngjëjve, kurrkush nuk e shtrëngoi njeriun të mëkatojë. Eva u josh nga "gjarpëri", por ishte e lirë për të mos pranuar këshillat e tij. "Mëkati fillestar" i saj dhe i Adamit ishte një akt i ndërgjegjshëm mosbindjeje, një mohim *i paramenduar* i dashurisë së Zotit, një kthesë *e zgjedhur lirshëm*, duke u larguar nga Zoti drejt vetes sonë (Gjeneza 3:2,3,11).

Në zotërimin dhe ushtrimin e vullnetit të lirë të njeriut nuk do të gjejmë aspak një shpjegim të plotë por të paktën fillesën e një përgjigjeje për problemin tonë. Përse Zoti i la ëngjëjt dhe njeriun të mëkatojnë? Përse Zoti lejoi të keqen dhe

vuajtjen? Përgjigjemi: Sepse është një Zot dashurie. Dashuria presupozon pjesëmarrje, dhe gjithashtu dashuria presupozon liri. Si një Trini dashurie Zoti deshi t'a ndajë jetën e tij me persona të krijuar, të bërë sipas imazhit të tij, që do të mund të përgjigjeshin me vullnet dhe me dëshirë në një marrëdhënie dashurie. *Atje ku nuk ka liri, nuk mund të ketë dashuri.* Shtrëngimi e përjashton dashurinë, siç e kish zakon ta thoshte Paul Evdokimov, Zoti mund të bëjë çdo gjë, përveçse të na shtrëngojë t'a duam. Zoti, si rrjedhojë - duke dashur t'a ndajë dashurinë e tij - nuk krijoi robotë që t'i bindeshin në mënyrë mekanike, por ëngjëj dhe qenie njerëzore të pajisura me zgjedhje të vullnetshme. Dhe me këtë, që t'a shtrojmë çështjen duke e përshtatur në mënyrë antropomorfe, Zoti rrezikoi, sepse bashkë me dhuratën e lirisë u dha gjithashtu dhe mundësia e mëkatit. Por ai që nuk rrezikon, nuk dashuron. Pa liri nuk do të kishte mëkat. Por pa liri njeriu nuk do të ishte sipas imazhit të Zotit; pa liri njeriu nuk do të mund të komunikonte me Zotin në një marrëdhënie dashurie.

Pasoja e rënies

Megjithëse u krijua për të jetuar në shoqëri me Trininë e Shenjtë, megjithëse u thirr për t'u rritur me dashuri nga imazhi hyjnor në ngjashmërinë hyjnore, njeriu zgjodhi në vend të kësaj një shteg që e çoi jo lart por poshtë. Flaku lidhjen hyjnore që është thelbi i tij i vërtetë. Në vend që të veprojë si ndërmjetës dhe si qendër bashkuese, krijoi përçarje me vetveten, përçarje midis tij dhe njerëzve të tjerë, përçarje midis tij dhe botës së natyrës. Ndërsa Zoti i besoi dhuratën e lirisë, ai në mënyrë sistematike u mohoi lirinë njerëzve të tjerë. Megjithëse u bekua me fuqinë për të shndërruar botën dhe për t'i dhënë domethënie të re, e keqpërdori këtë forcë për të sajuar mjete shëmtimi dhe shkatërrimi. Pasoja e këtij shpërdorimi, veçanërisht qysh nga koha e revolucionit industrial, janë tmerrësisht të dukshme me ndotjen e vrullshme të mjedisit.

"Mëkati fillestar" i njeriut, kthesa e tij nga hyjcentrizmi në egocentrizëm, do të thoshte në radhë të parë se nuk e shikonte më botën dhe qeniet e tjera njerëzore me një mënyrë eukaristike, si një mister kungimi me Zotin. Pushoi t'i konsiderojë si një dhuratë që do t'i rikthehej me mirënjohje Dhuruesit dhe filloi t'i trajtojë si pronë të tij, nga e cila mund të shtijë në dorë, të shfrytëzojë dhe të gëlltisë. Si rrjedhojë nuk i shihte më personat dhe gjërat e tjera ashtu siç janë brenda tyre dhe brenda Zotit, por i shihte sipas ëndjes dhe kënaqësisë që mund t'i jepnin. Dhe pasoja e kësaj ishte se u kap në rrethin vicioz të shthurjes së tij, që bëhej gjithnjë më i pangopur sado që t'a kënaqte. Bota pushoi së qënuri e tejdukshme - një dritare përmes së cilës vështronte Zoti - dhe u mugëtua; pushoi së qënuri jetëdhënëse dhe filloi t'i nënshtrohet prishjes dhe

vdekjes. "Sepse dhé je, dhe në dhé do të kthehesh" (Gjeneza 3:19). Kjo është e vërtetë për njeriun e rënë dhe për çdo krijesë, menjëherë sa këputet nga i vetmi burim jete, nga vetë Zoti.

Pasojat e rënies së njeriut ishin fizike dhe morale. Në planin fizik njerëzit filluan t'i nënshtrohen mjerimit dhe sëmundjes, dobësisë dhe shpërbërjes trupore në moshën e pleqërisë. Gëzimi i gruas që sjell në botë një jetë të re u përzie me dhimbjet e lindjes (Gjeneza 3:16). Asgjë nga këto nuk është pjesë e planit fillestar të Zotit për njerëzimin. Si pasojë e rënies, burrat dhe gratë gjithashtu i nënshtrohen ndarjes së shpirtit nga trupi me vdekjen fizike. Dhe megjithatë vdekja fizike nuk duhet të shihet fillimisht si ndëshkim, por si mënyrë ngushëllimi e dhënë nga Zoti që dashuron. Brenda mëshirës së tij Zoti, nuk pranoi që njerëzit të vazhdojnë të jetojnë pafundësisht mes një bote të rënë, të dhënë përgjithmonë në rrethin vicioz të trillimeve të tyre, dhe kështu na dha një mënyrë shpëtimi. Sepse vdekja nuk është fundi i jetës, por fillesa e ripërtëritjes. I mbajmë shpresat përtej vdekjes fizike, në ribashkimin e ardhshëm të trupit dhe shpirtit në ngjalljen e të gjithëve Ditën e Fundit. Pra duke ndarë trupin nga shpirti në vdekje, Zoti vepron si poçari; kur ena deformohet dhe shtrembërohet, e thyen deltinën copë - copë për ta ndërtuar prapë (Shih: Jeremia 18:1-6). Kjo theksohet në shërbesën ortodokse të varrimit:

*Ti që më gatove qëmoti nga e mosqena
dhe më nderove me shëmbëllesën tënde të perëndishme,
dhe më ktheve prapë në dhé,
prej të cilit më more, nga shkelja e porosisë,
sillmë prapë në ngjashmërinë tënde,
dhe kthema prapë bukurinë e lashtë.*

Në planin moral, si pasojë e rënies, njerëzit zhgënjehen, mërzhiten, dëshpërohen. Puna që destinohej të ishte burim gëzimi për njeriun dhe një mjet komunikimi me Zotin, duhet të kryhet tashmë për pjesën më të madhe pa dëshirë, "me djersën e ballit" (Gjeneza 3:19). Dhe nuk ishin vetëm këto. Njeriu u bë subjekt i një tjetërsimi të brendshëm, ndërsa vullneti i tij u dobësua dhe vetë u përça në vetvete, u bë armiku dhe xhelati i vetvetes. Siç thotë shën Pavli: "E di se nuk rri tek unë (domethënë në trupin tim) asgjë e mirë; vullneti për të bërë të mirën është, por nuk kam fuqi për t'a bërë, sepse nuk bëj të mirën që dua, por të keqen që nuk dua, këtë bëj... Mjerë unë i gjori! Kush do të më ruajë?" (Romakët 7:18,19,24). Këtu Shën Pavli nuk thotë vetëm se ka një konflikt brenda nesh, midis së mirës dhe së keqes. Thotë se shumë shpesh e gjejmë vetveten moralisht të paralizuar; sinqerisht dëshirojmë të zgjedhim të mirën, por gjendemi të robëruar në një situatë ku të gjitha zgjedhjet tona përfundojnë tek e

keqja. Dhe secili nga ne di nga përvoja personale se çfarë do të thotë pikërisht shën Pavli.

Por shën Pavli nënvizon jo pa qëllim: "E di se nuk rri tek unë, d.m.th. në mishin tim, asgjë e mirë". Asketizmi ynë është luftë kundër mishit dhe jo kundër trupit. "Mishi" nuk është njësoj me "trupin". Termi "mish", siç është përdorur në pjesën që sa u përmend, do të thotë gjithçka që brenda nesh është mëkatore dhe e kundërt me Zotin. Si rrjedhojë nuk është vetëm trupi por edhe shpirti, në njeriun e rënë, që është bërë mishëror dhe shqisor. Duhet të urrejmë mishin, por nuk duhet të urrejmë trupin që është vepër e Zotit dhe tempull i Shpirtit të Shenjtë. Si rrjedhojë vetëmohimi asketik është një luftë kundër mishit; dhe jo kundër trupit por *për* trupin. Ashtu si at Sergjei Bulgakov thoshte: "Vraje mishin që të fitosh një trup". Asketizmi nuk është vetërobërim por rruga drejt lirisë. Njeriu është një rretë e koklavitur mbushur me kontradikta me vetveten; vetëm nëpërmjet asketizmit ai mund të fitojë spontaneitet.

Asketizmi, kur kuptohet kështu, si një betejë kundër mishit, aspektit mëkatar dhe të rënë të vetvetes, është diçka që qartazi kërkohet nga *të gjithë* të krishterët dhe jo vetëm nga murgjit. Prirja murgjërore dhe prirja e martesës-udha e mohimit dhe udha e pohimit- duhet të shihen si paralele dhe plotësuese. Murgu ose murgesha nuk janë dualistë, por, në të njëjtën shkallë që e bën i krishteri brenda martesës, përpiqen të proklamojnë mirësinë e lindur të krijesës lëndore dhe të trupit njerëzor; dhe me të njëjtin argument, i krishteri i martuar ftohet në asketizëm. Ndryshimi qëndron vetëm në rrethanat e jashtme nën të cilat zhvillohet lufta asketike. Që të dy janë njësoj asketike dhe njësoj materialiste (duke e përdorur fjalën në kuptimin e vërtetë të krishterë). Që të dy mohojnë mëkatën dhe pohojnë botën.

Tradita ortodokse, pa nënvlerësuar pasojat e rënies, gjithsesi nuk beson se rënia erdhi si rezultat i një "prishjeje tokësore", siç e pohojnë kalvinistët në çastet më pesimiste të tyre. Imazhi hyjnor brenda njeriut është fshehur, por nuk është zhdukur. Zgjedhja e lirë e tij është kufizuar në të ushtruarit e saj, por nuk është prishur. Madje dhe në një botë të rënë njeriu është akoma i aftë për vetëmohim të vërtetë dhe përdëllim dashurie. Qoftë dhe brenda një bote të rënë njeriu ruan ende njëfarë njohjeje të Zotit dhe me hirin hyjnor mund të komunikojë me të. Brenda faqeve të Dhjatës së Vjetër ka shumë shenjtorë, burra dhe gra si Abrahami, Sara, Josifi dhe Moisiu, Ilia, Jeremia; por dhe ata që nuk i përkasin popullit të zgjedhur të Izraelit, figura si Sokrati, që jo vetëm lëçitën të vërtetën, por edhe e përjetuan atë. Megjithatë duhet pranuar, se mëkati njerëzor - mëkati fillestar i Adamit, i njësuar me mëkatet personale të çdo brezi pasardhës - ka

krijuar një hendek të tillë midis Zotit dhe njeriut, saqë njeriu me gjithë përpjekjet e tij nuk do të mund t'a mbushë.

Askush nuk bie vetëm

Për traditën ortodokse, pra, mëkati fillestar i Adamit prek gjithë gjininë njerëzore dhe ka pasoja fizike dhe morale; ka pasoja jo vetëm përsa i përket sëmundjes dhe vdekjes fizike, por edhe për dobësinë e paralizën morale. Por mos vallë kushtëzon gjithashtu një fajësi të trashëguar? Këtu ortodoksia është më e rezervuar. Mëkati fillestar nuk duhet të interpretohet me terma juridikë apo gjysmë biologjikë, sikur të ishte "njollë" fizike e një faji, që përcillet me marrëdhëniet seksuale. Kjo ide, që pa dyshim njihet si pikëpamje augustiniane, është e papranueshme në ortodoksi. Doktrina e mëkatit fillestar nënkupton më saktë se lindemi mes një mjedisi ku është e lehtë të bësh të keqen dhe e vështirë të bësh të mirën; e lehtë të lëndosh të tjerët dhe e vështirë të shërosh plagët e tyre, e lehtë të krijosh mosbesim tek njerëzit sesa të fitosh besimin e tyre. Kjo do të thotë se të gjitha janë të ndërvarura në solidaritetin e gjinisë njerëzore, në të vepruarit përgjithësisht të gabuar dhe në të menduarit e gabuar, e si rrjedhojë në të qënurit e gabuar. Dhe në këtë grumbull gabimesh me vetëdije ne kemi shtuar veprimet tona të paramenduara mëkatore. Hendeku sa vete e zgjerohet.

Këtu, në solidaritetin e gjinisë njerëzore, gjejmë një shpjegim për padrejtësinë në dukje të doktrinës së mëkatit fillestar. Përse - pyesim - duhet të vuajë gjithë gjinia njerëzore nga rënia e Adamit? Përse duhet të ndëshkohen të gjithë për mëkatin e një njeriu? Përgjigja është se njerëzit, të bërë sipas imazhit të Zotit trinitar, janë të ndërvarur dhe bashkëtrashëgimtarë. Asnjë njeri nuk është si një ishull. Jemi "pjesë të njëri - tjetrit" (Efesianët 4:25), dhe së këndejmi çdo veprim që kryen cilido anëtar i gjinisë njerëzore, prek në mënyrë të pashmangshme gjithë të tjerët. Madje edhe sikur të mos jemi, në kuptimin e ngushtë, fajtorë për mëkatet e të tjerëve, jemi në njëfarë mënyre, gjithmonë *të përzier*.

"Nëse dikush bie, - bën të ditur Aleksei Khomiakov, - bie vetëm; por askush nuk shpëtohet vetëm." Mund të thoshte gjithashtu se askush nuk bie vetëm? Stareç Zosimai në *Vëllezërit Karamazov* të Dostojevskit i afrohet më tepër të vërtetës, kur thotë se secili nga ne është "përgjegjës për secilin dhe për çdo gjë":

Ka vetëm një rrugë për shpëtim dhe kjo është të bësh vetveten përgjegjës për mëkatet e gjithë njerëzve. Sapo të ndjesh përgjegjësinë për gjithë mëkatërinë, për çdo gjë dhe për secilin, do të shohësh menjëherë se kështu është me të vërtetë, dhe se ti duhet të fajësohesh për secilin dhe për të gjitha gjërat.

Një Zot që vuan?

A e pikëllon zemrën e Zotit mëkati ynë? A vuan ai kur ne vuajmë? Kemi të drejtë t'i themi njeriut që vuan: "Vetë Zoti, *këtë moment këtu*, vuan çka vuan edhe ti, dhe e kapërcen"?

Duke dëshiruar të ruajnë transhendencën hyjnore, etërit, grekë dhe latinë, këmbëngulnin në "të papësuarit" e Zotit. E interpretuar rreptësisht, kjo do të thotë se ndërsa Zoti i trupëzuar mund të vuajë dhe vuan, Zoti vetë nuk vuan. Pa hedhur poshtë mësimin patristik, nuk mund të themi diçka më tepër se kjo? Në Dhjatën e Vjetër, shumë më herët nga Mishërimi i Krishtit, gjejmë të formuluar në lidhje me Zotin: "...dhe u përdëllye shpirti i tij për njeriun e Izraelit" (Gjyqtarët 10:16). Gjetkë, në Dhjatën e Vjetër, vihen fjalë si këto në gojën e Zotit: "Vallë Efremi a s'është biri im i dashur, a s'e kam unë djalë për zemër? Pse, sa herë që i kanosem, aq herë prapë mendoj për të; prandaj zemra ime për të dridhet" (Jeremia 38:20). "Si të heq dorë prej teje, Efrem? Si të të braktis ty, o Izrael? Zemra ime dërmohet" (Hoseja 11:8).

Nëse këto fragmente kanë njëfarë kuptimi, duhet të dalim në përfundimin se madje dhe para Trupëzimit/Mishërimit Zoti përzihet direkt me vuajtjet e krijimit të saj. Gjendja jonë e mjeruar i shkakton dhembje Zotit; lotët e Zotit bashkohen me lotët e njeriut. Një respekt i përshtatshëm për një përqsasje apofatike (mohore) do të na bënte me siguri, të kursyer për t'i dhënë Zotit ndjenja njerëzore me një mënyrë të vrazhdë a shijekeqe. Por të paktën jemi të detyruar t'a pohojmë. "Dashuria i bën vuajtjet e të tjerëve, vuajtjet tona", tregon *Libri i të varfërve në shpirt*. Në qoftë se kjo është e vërtetë për dashurinë njerëzore, është shumë më tepër e vërtetë për dashurinë hyjnore. Përderisa Zoti është dashuri dhe krijoi botën si një akt dashurie - dhe përderisa Zoti është personal, dhe personaliteti kushtëzon pjesëmarrje - Zoti nuk është indiferent në hidhërimet e kësaj bote të rënë. Në qoftë se unë si qenie njerëzore mbetem i paprekur nga dhimbja e një tjetri, në ç'mënyrë do t'a dua atë me të vërtetë? Sigurisht, atëherë, Zoti njëjtësohet me krijesën në mjerimin e saj.

Është e drejtë ajo që është thënë se ekzistonte një kryq në zemrën e Zotit para se të mbillej një tjetër jashtë Jeruzalemit; dhe ndërsa kryqin e drunjtë e kanë zbritur, kryqi në zemrën e Zotit qëndron ende. Është kryqi i dhembjes dhe i triumfit - i të dyjave bashkë. Dhe ata që do të mund të besojnë këtë do të shohin se gëzimi është i përzier me kupën e hidhërimit të tyre. Do të marrin pjesë, në një nivel njerëzor, në përvojën hyjnore të vuajtjes ngadhënjimtare.

* * *

Ti që mbulon vendet e larta me ujëra,
Vë rërën si kufi në det
dhe që i mba në pëllëmbë të gjitha,
të himnon dielli, të lëvdon hëna,
ty të blaton himne gjithë krijesa,
Krijuesit dhe Bërësit përjetë.

Nga Triodi

I madh je ti, o Zot, dhe të mrekullueshme janë veprat e tua dhe asnjë fjalë s'mund të himnojë çuditë e tua.

Ti, me vullnetin tënd, i bërë të gjitha nga e mosqena, dhe e mban krijesën me pushtetin tënd, dhe e sundon botën me përkujdesjen tënde.

Ti, kur i dhe trajtë krijimit prej katër elementësh, e kurorëzove çarkun e vitit me katër stinë.

Përpara teje dridhen gjithë fuqitë shpirtërore;

ty të këndon dielli,

ty të lavdëron hëna, përpara teje dalin yjet,

ty të bindet drita,

ty t'a kanë frikën humnerat,

ty të shërbejnë burimet.

Ti e shpalose qiellin si kurtinë, ti e themelove dheun mbi ujëra, ti vure rërën si mur rreth detit, ti derdhe erën për të marrë frymë.

Ty të meshojnë fuqitë ëngjëllore, koret e kryeëngjëjve ty të falen;

Qeruvimet e shumësyshme dhe Serafimet gjashtëkrahëshe, që të rrinë rreth e përçark e fluturojnë rrotull, mbulojnë fytyrën nga frika e lavdisë sate të paarritshme...

Që me elementë, me ëngjëj, me njerëz, me gjëra të dukshme e të padukshme, të lavdërohet emri yt i tërëshenjtë, bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë, e në jetë të jetëve. Amin.

Uratë e Bekimit të Madh të Ujërave (E kremte e Hyjshfaqjes/Epifanisë)

Të rrezikuarit hyjnor, që është brenda vendimit të Zotit për të krijuar qenie sipas imazhit dhe ngjashmërisë së Zotit, është kulmi i gjithfuqishmërisë, ose më mirë, kapërcimi i kësaj maje me marrjen përsipër të dobësisë në mënyrë të

vullnetshme. Sepse "dobësia e Perëndisë është më e fortë se njerëzit" (1 Korinthianët 1:25).

Vladimir Lossky

Gjithësia është vreshti që iu dha njerëzve nga Zoti. "Të gjitha gjërat janë për ne, jo ne për ato", - thotë Shën Joan Gojarti. Çdo gjë është dhuratë e Zotit, që i jepet njeriut si shenjë dashurie. Të gjitha gjërat dëshmojnë forcën e dashurisë së Zotit, vullnetin e tij të mirë ose hirin, dhe na e përçojnë. Si pasojë çdo gjë është një bartës i kësaj dhurate hyjnore të dashurisë, ashtu si çdo dhuratë që i bëjmë njëri - tjetrit është një shenjë dhe një bartës i dashurisë për njëri - tjetrin. Por një dhuratë kërkon një "kundërdhuratë", në mënyrë që kjo dashuri të bëhet e ndërsjelltë dhe të sendërtohet. Por megjithatë, për Zotin, njeriu nuk mund të kthejë asgjë nga ato që ka marrë nga Zoti për nevojat e tij; kështu dhurata e njeriut ndaj Zotit është flijimi dhe ai e blaton me falënderim. Dhurata e njeriut për Zotin është flijimi dhe "eukaristia" me kuptimin më të gjerë.

Madje, me blatin e botës ndaj Zotit, si një vepër flijimi, vëmë mbi të vulën e veprës sonë, të arsyetimit tonë, të frymës së flijimit dhe të lëvizjes sonë drejt Zotit. Sa më shumë kuptojmë vlerën dhe pasurinë e hirit hyjnor dhe zhvillojmë mundësitë e tij, duke shtuar kështu dhuntitë që na janë dhënë, aq më tepër himnojmë Zotin dhe i japim gëzim, duke provuar në këtë mënyrë, se marrim pjesë aktivisht në dialogun e dashurisë me të.

At Dumitru Staniloae

Në kryekishën vigane që është gjithësia e Zotit, çdo njeri qoftë dijetar, qoftë punëtor krahu, ftohet të veprojë si prift i gjithë jetës së tij, të marrë çfarë është njerëzore, dhe t'a shndërrojë në një blatin dhe në një himn lavdie.

Paul Evdokimov

Në qoftë se disa njerëz bëhen lutje - lutje që janë me të vërtetë "të kulluara" dhe krejt të padobishme në dukje - shndërrojmë gjithësinë vetëm me faktin e pranisë së tyre, me vetë ekzistencën e tyre.

Oliver Clement

Je një botë brenda një bote; shih brenda teje dhe do të shohësh atje gjithë krijimin. Mos shiko gjërat e jashtme, por përqendroje gjithë vëmendjen tek ajo që ndodhet brenda. Mblidhe gjithë mendjen tënde brenda thesarit shpirtëror të shpirtit tënd, dhe gatit për Zotin një faltore pa imazhe.

Shën Nili i Angjirës

Rusi beson se dikush mund të njohë një gjë, si njeri, vetëm përmes pjesëmarrjes.

E mira dhe e keqja, këtu në tokë, janë të lidhura në mënyrë të pashkëputur. Për ne kjo është misteri i madh i jetës mbi tokë. Atje ku e keqja është në fuqinë më të madhe, atje gjithashtu duhet të ekzistojë e mira më e madhe. Kjo për ne nuk është aspak hipotezë. Është aksiomë.

Nuk duhet t'i shmangemi të keqes, por së pari duhet të marrim pjesë tek ajo, dhe t'a kuptojmë përmes pjesëmarrjes, dhe pastaj me arsyetimin t'a shenjtërojmë dhe t'a shndërrojmë.

Julia de Beausobre

Shenjtoret duhet të pranohen jo vetëm për veten e tyre, por aq dhe për hir të fqinjëve të tyre, sepse pa dashuri të gjallë nuk mund të bëhen të përsosur. Kështu ruhet gjithë universi dhe secili ndihmohet me një përkujdesje providence nga tjetri.

Shën Mark Murgu

Zoti nuk këmbëngul as edhe dëshiron të vajtojme me agoni në zemër; madje urimi i saj është se nga dashuria për të duhet të gëzohemi me harë në shpirt. Flake mëkatin dhe lotët janë të tepërt; atje ku nuk ka plagë, nuk nevojitet bar plagësh. Para rënies Adami nuk derdhte aspak lotë dhe në të njëjtën mënyrë nuk do të ketë më lotë mbas ngjalljes së të vdekurve, ku mëkati do të jetë asgjësuar. Sepse atëherë dhimbja, hidhërimi dhe vajtimi do të kenë ikur larg.

Shën Joani i Shkallës

Lavdia tek e cila ftohet njeriu është përpjekja për t'i ngjarë sa më tepër Zotit duke u bërë më njerëzor.

At Dumitru Staniloae